



Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri

Datë: 13/05/2026

TERMA REFERENCE

AVOKAT

Organizata	Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri
Adresa:	Rr. "Nikolla Tupe", P. 2/4, Ap. 15, Tiranë, Shqipëri.
E-mail:	genderjusticealbania@gmail.com
Pozicioni i shërbimit të kërkuar:	Avokat për ofrimin e ndihmës juridike parësore dhe dytësore për gra dhe vajza, viktime të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.
Lloji i kontratës:	Kontratë Shërbimi
Periudha e kontraktimit:	Maj 2026 – Prill 2027
Data e mundshme e fillimit të punës:	Maj 2026
Zona gjeografike:	Bashkia Tiranë
Afati i dorëzimit të aplikimit:	25/05/2026

1. HYRJE

Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri (QDGJSH) është një organizatë jofitimprurëse, e pavarur, jo-politike, e cila punon për fuqizimin e grave dhe vajzave, mbrojtjen e drejtave të tyre dhe lufton pabarazitë gjinore. QDGJSH është themeluar me iniciativën e tre grave aktiviste të shoqërisë civile të cilat, prej më tepër se 15 vitesh, kontribuojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të grave në Shqipëri. QDGJSH është regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë me vendimin nr. 1738, datë 28/06/2022. Sipas legjislacionit në fuqi, QDGJSH është regjistruar edhe pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, Tiranë me nr. NIPT: M22002451K.

QDGJSH po zbaton në projektin “Sigurimi i aksesit cilësor në drejtësi për gratë dhe vajzat, viktime të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje”, në kuadër të projektit të UNDP Albania “Shërbime të Përmirësuara të Ndihmës Juridike Cilësore – EQUALS”.

Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri

Rr. "Nikolla Tupe", P. 2/4, Ap. 15, Tiranë, Shqipëri

Web: www.gjalbania.org; email: genderjusticealbania@gmail.com; Tel: +355692667531



Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri

Në kuadër të projektit, QDGJSH do të ofrojë ndihmë juridike parësore dhe dytësore për 70 raste, gra dhe vajza viktime të dhunës dhe po kërkon të kontraktojë një avokat të licencuar.

2. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË KRYESORE

- Të ofrojë ndihmë juridike parësore për të paktën 40 raste, gra dhe vajza, viktime të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje;
- Të ofrojë ndihmë juridike dytësore për të paktën 30 raste, gra dhe vajza, viktime të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje;
- Të dokumentojë shërbimin e ofruar për çdo rast në dosje përkatëse;
- Të ruajë konfidencialitetin për rastet që asiston;
- Të kryejë analiza të legjislacionit shqiptar dhe ndërkombëtar mbi dhunën me bazë gjinore, dhunën në familje, të drejtat e grave të cilat do të vendosen në funksion të punës avokuese të QDGJSH;
- Të përfaqësojë QDGJSH në takime, tryeza konsultative, konferenca, trajnime dhe aktivitete të tjera që lidhen me aspektin juridik të të drejtave të grave;
- Të raportojë periodikisht pranë QDGJSH mbi ecurinë e punës dhe sfidave/vështirësive që mund të ndikojnë në mbarëvajtjen e ofrimit të shërbimit;
- Të hartojë një raport të shkruar mbi ecurinë e punës para kryerjes së pagesave dhe ta dorëzojë atë të firmosur pranë zyrës së financës së QDGJSH;
- Të plotësojë kohëshënuesit dhe t'i dorëzojë ato pranë QDGJSH para kryerjes së pagesave për shërbimin;
- Të mbajë kontakte dhe bashkëpunim korrekt me stafin e QDGJSH;
- Të tregojë korrektësi në zbatimin e orareve dhe afateve të cilat janë vendosur paraprakisht.

3. KUALIFIKIME DHE AFTËSI TË KERKUARA

- Diplomë në degën drejtësi;
- Zotërimi i licencës së avokatit;
- Eksperienca të mëparshme pozitive në punën me viktime të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje;
- Aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për të me ekipin e QDGJSH;
- Aftësi shumë të mira komunikuese.

4. PROCESI I APLIKIMIT

Aplikantët duhet të dërgojnë me shkrim në adresën elektronike ose adresën postare të Qendrës për Drejtësi Gjinore (pranohet dokumentacion i dërguar dorazi), dokumentacionin e poshtëshënuar:

- Curriculum Vitae;

Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri

Rr. "Nikolla Tupe", P. 2/4, Ap. 15, Tiranë, Shqipëri

Web: www.gjalbania.org; email: genderjusticealbania@gmail.com; Tel: +355692667531



Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri

- Ofertë financiare në monedhën LEK për ditë pune;
- Kopje e diplomave dhe licenceës së avokatit.

Adresë elektronike: genderjusticealbania@gmail.com; adena.vangjeli@gjalbania.org

Adresë postare: Rr. "Nikolla Tupe", P. 2/4, Ap. 15, Tiranë, Shqipëri.

5. AFATET

Afati për dërgimin e aplikimit: 25/05/2026.

Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri

Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri

Rr. "Nikolla Tupe", P. 2/4, Ap. 15, Tiranë, Shqipëri

Web: www.gjalbania.org; email: genderjusticealbania@gmail.com; Tel: +355692667531